


30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE




Akti i Shërbimeve Digjitale në legjislacionin shqiptar: Institucionet e përfshira në proces, tryezë dialogu me ekspertin e BE-së



Kryetarja e AMA-s në Bruksel: Angazhim i plotë për transpozimin e Aktit European të Lirisë së Medias

DËRGO ANKESË PËR PLATFORMËN X




Lufta kundër piraterisë, raportohet një tjetër shkelës i ligjit në Tiranë

Vijojnë aksionet kundër transmetimeve pirate nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, ndërsa është evidentuar një tjetër shkelje e ligjit në qytetin e Tiranës...

Sfidat aktuale të tregut mediatik, Krasniqi takon në Prishtinë drejtues të Komisionit të Pavarur të Mediave

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive takoi në Kosovë kryeshefin ekzekutiv të Komisionit të Pavarur...



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Fq. 3

AMA thirrje mediave audiovizive: Forconi standardet e raportimit për ngjarje që përfshijnë të mitur dhe individë në situata të vështira shoqërore

Autoriteti i Mediave Audiovizive u bën thirrje të gjitha mediave audiovizive për forcimin e standardeve etike dhe ...

Kryetarja e AMA-s në Bruksel: Angazhim i plotë për transpozimin e Aktit European të Lirisë së Medias


Transpozimi i Aktit European të Lirisë së Medias (EMFA) në legjislacionet kombëtare, ishte qëllimi i vizitës së Kryetares së Autoritetit të Mediave Audiovizive në Bruksel. Ajo mori pjesë në tryezën e diskutimeve mes vendeve kandidate dhe përfaqësuesve të Bashkimit European, e organizuar në kuadër të instrumentit TAIEK. Krasniqi u shpreh në këtë takim se AMA ka vullnetin e plotë dhe kapacitetet e duhura profesionale për transpozimin e EMFA-s në legjislacionin shqiptar si dhe zbatimin e këtij Akti.

[Lexo më shumë](#)



Akti i Shërbimeve Digjitale në legjislacionin shqiptar: Institucionet e përfshira në proces, tryezë dialogu me ekspertin e BE-së

Në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga Kapitulli 10, "Transformimi Digjital dhe Media", me iniciativën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, u zhvillua takimi dialogues mbi harmonizimin e legjislacionit shqiptar me Aktin e Shërbimeve Digjitale (DSA). I pranishëm ishte dhe eksperti i Bashkimit European, Z. Francesco Sciacchitano, i cili prezantoi në detaje DSA-në, risitë që ky akt sjell në rregullimin e platformave online, si dhe mënyrën e implementimit dhe transpozimit të tij në legjislacionin shqiptar. [Lexo më shumë](#)




Lufta kundër piraterisë, raportohet një tjetër shkelës i ligjit në Tiranë

Vijojnë aksionet kundër transmetimeve pirate nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, ndërsa është evidentuar një tjetër shkelës i ligjit në qytetin e Tiranës. Domain-et përkatëse janë raportuar pranë AKEP-it, me qëllim marrjen e masave të mëtejshme ligjore. AMA thekson se mbetet e palëkundur në luftën kundër piraterisë audiovizive dhe në mbështetje të operatorëve të ligjshëm në treg.

[Lexo më shumë](#)

Sfidat aktuale të tregut mediatic, Krasniqi takon në Prishtinë drejtues të Komisionit të Pavarur të Mediave



Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive takoi në Kosovë kryeshefin ekzekutiv të Komisionit të Pavarur të Mediave, Z. Niman Racaj, anëtarin e KPM, Z. Fitim Velu dhe zyrtarë të tjerë të rregullatorit të Kosovës për të diskutuar mbi sfidat aktuale të tregut mediatic. Në takim u trajtuan procese të rëndësishme të rregullimit, si transpozimi i Aktit European për Lirinë e Medias, EMFA, Akti i Shërbimeve Digjitale, DSA, në legjislacionin shqiptar dhe harmonizimin e këtyre akteve në atë të Kosovës.

[Lexo më shumë](#)



AMA thirrje mediave audiovizive: Forconi standardet e raportimit për ngjarje që përfshijnë të mitur dhe individë në situata të vështira shoqërore

Autoriteti i Mediave Audiovizive u bën thirrje të gjitha mediave audiovizive për forcimin e standardeve etike dhe profesionale në raportimin e ngjarjeve me ndjeshmëri të lartë, që përfshijnë fëmijë, gra dhe individë në situata të vështira shoqërore. Raportimi i këtyre rasteve kërkon vëmendje dhe kujdes të posaçëm editorial, pasi pasojat e ekspozimit mediatic mund të jenë afatgjata dhe të pakthyeshme, veçanërisht për fëmijët.

[Lexo më shumë](#)